



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 13 -2009
Prishtinë, më 23. prill. 2009, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni, Adem Salihaj, Bajram Kosumi, Kolë Berisha, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli dhe Armend Zemaj.

Munguan: Branislav Grbiq, Dzezair Murati, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

Të pranishëm: Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti, Reshit Gashi – KDI, Lejla Selimi - OSBE, Naim Hajdari - OSBE dhe Vlora Marmullaku.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë

REND DITE

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 15 prillit 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2008;
4. Të ndryshme.

Kryetari – I përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i falënderoi përfaqësuesit e mediave dhe organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. I njoftoi se për këtë mbledhje është ftuar edhe z. Hasan Preteni, drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit dhe do të shqyrtohet Raporti vjetor i Agjencisë për vitin 2008.

Theksoi se për këtë mbledhje janë edhe dy projektligje për bazën kushtetuese, të cilat kanë kaluar në seancë plenare:

1. Projektligji për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike dhe
2. Projektligji për armët.

Të dy këto projektligje njëzëri gjetën bazë kushtetuese nga anëtarët e Komisionit.

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit edhe për propozimvendimin e Ministrisë së Drejtësisë, që iu paraqit Komisionit për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Ky propozim duhet të shqyrtohet të hënën, në mbledhjen e Komisionit. Me këtë u pajtuan edhe anëtarët e tjerë të Komisionit. Për këtë ditë u caktua edhe shqyrtimi i Raportit të Institutit Gjyqësor të Kosovës. Për këtë çështje do të ftohet edhe udhëheqësi i këtij instituti. I njoftoi anëtarët e Komisionit se për Ligjin për të drejtën sendore janë kryer të gjitha punët në Komisionin tonë. Do të kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa deklarata financiare, që ky ligj nuk e ka, sepse kur është dorëzuar në Kuvend nuk ishte kërkuar.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2008

Në mbledhjen e Komisionit, me ftesë, ishte i pranishëm edhe drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Kryetari i dëshiroi mirëseardhje në emër të Komisionit. Shtoi se arsyeja e ftesës është shqyrtimi i Raportit të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit. Hapi debat.

Drejtori i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit - z. Hasan Preteni, e falënderoi Komisionin për ftesën. Fillimisht diskutoi për historikun e Agjencisë, për ligjet në bazë të të cilave punon dhe funksionon ajo. Theksoi se ky është raporti i dytë i paraqitur. Diskutoi edhe për punën e Agjencisë, për mënyrën si luftohet dhe si parandalohet korrupsioni. Vuri në dukje se këtë raport për vitin 2008, që është para jush, deputetë të nderuar, e kam dorëzuar edhe në Këshill të Agjencisë. Në diskutimin e tij, para anëtarëve të Komisionit, shkoqiti pjesë të raportit. Filloi me historikun, shtoi se është themeluar në vitin 2006 dhe është funksionalizuar në vitin 2007. Qëllimi dhe puna e Agjencisë janë zbulimi dhe hetimi i rasteve korruptive, parandalimi dhe luftimi e dukurisë së korrupsionit. Ligji aktual kundër korrupsionit është bazë ligjore e funksionimit të Agjencisë, kurse fondet për funksionimin e saj sigurohen nga buxheti i Kosovës. Duke folur për raportin përmendi me numra dhe me shifra raste të mbyllura, raste të proceduara në Prokurorinë Publike kompetente dhe në organet policore. I theksoi edhe sukseset e arritura, bashkëpunimin me institucionet e tjera, si dhe vështirësitë që i hasin zyrtarët e Agjencisë në kryerjen e detyrave.

Kryetari - E falënderoi drejtorin e Agjencisë për Raportin e paraqitur. Shtoi se e respektojmë punën e Agjencisë dhe i dimë vështirësitë. Jemi të vetëdijshëm se as

legjislacioni, as infrastruktura nuk i plotëson nevojat e Agjencisë. Komisioni është i interesuar që Ligji antikorrupsion të funksionojë. E dimë se ka probleme, por duhet të nxirren edhe ligje të tjera, si p.sh.: ligji i prejardhjes së pasurisë dhe ligji i konfliktit të interesit etj. Theksoi se në Kuvend nuk ka kaluar strategjia e Agjencisë, sepse nuk ka pasur plan të veprimit, edhe pse kjo strategji ka kaluar në këtë komision.

Bajram Kosumi – Për Raportin e vitit 2008 tha se është me shifra, por mendon se është i thatë. Nga diskutimi i tij dolën tri sugjerime:

Duhet të shikohen me kujdes marrëdhëniet ndërmjet Agjencisë, Prokurorisë dhe gjykatave, sepse është e pakuptueshme që prej 100 rasteve me natyrë korruptive, të ngrihen vetëm katër aktakuza.

Do të ishte mirë t'i hetonim 100 dosjet e Agjencisë të dërguara në Prokurori, sepse kanë mbetur pa u zgjidhur. Komision duhet ta hetojë kush po e mbron korrupsionin.

Do të ishte mirë t'u bënim apel Kuvendit dhe Qeverisë që Agjencia të përkrahet politikisht në punën e vet.

Ibrahim Makolli - Pyeti si është kërkuar në raport shkarkimi për disa zyrtarë të lartë? Si po dalin emrat e zyrtarëve në publik dhe nga kush, sepse këta njerëz mund të jenë edhe të pafajshëm? Pra prej nga marrin emrat? Ngriti edhe çështjen e krijimit të një komisioni parlamentar hetimor për t'u hetuar rastet që i përmendi edhe parafolësi. Shfaqti dilemën se disa deputetë janë edhe anëtarë të Këshillit të Agjencisë. Tha se ky është konflikt interesi. Po ashtu shfaqti shqetësim, pse Agjencia shpesh paraqitet si e vetme në luftimin e korrupsionit. Propozoi që në pasqyrat e Kuvendit të dallohet a është fjala për deputetët apo për punonjësit e shërbimit civil të administratës. Na sqaroni, ju lutem, sepse shpesh keni deklaruar se i keni shpëtuar tre milionë. Si i keni shpëtuar?

Armend Zemaj - Vlerësoi punën dhe Raportin e Agjencisë. Shtoi se po të kishim polici efikase, ndoshta nuk do të kishte nevojë fare për agjenci. Megjithatë kjo agjenci ka bërë punë të madhe në sensibilizimin e luftimit të korrupsionit në opinionin publik. Kërkoj sqarime edhe për konfliktin e Këshillit dhe të Agjencisë rreth dosjeve.

Theksoi se kur flitet për Qeverinë, duhet të identifikohet për cilën ministri është fjala dhe të flitet në njëjës. Pati vërejtje edhe rreth paraqitjes së deklaratës së pasurisë, sepse kur e kam paraqitur, askush nuk më ka pyetur për letërnjoftim, as kush jam. Kishte mundësi që këtë deklaratë ta paraqiste secili në vend timin.

Adem Salihaj - Shtoi se Agjencia është një ndihmë e veçantë në luftimin e korrupsionit, por po shihet se nuk u arritën rezultatet që priteshin. Kjo duket edhe nga lëndët e pazgjidhura. Mendoj për një strategji tjetër të Agjencisë, mirëpo pa përkrahje të gjithanshme, lufta kundër korrupsionit është e vështirë. Agjencia nuk ka mundësi të bashkëpunojë me komunat. Kjo çështje është mirë të bëhet publike.

Kryetari - E pyeti drejtorin e Agjencisë: Ju keni paraqitur shumë shkresa në Prokurori, por keni shfaqur shqetësim se Prokuroria një numër të madh të tyre i ka refuzuar si të pabaza, kurse disa fare nuk i ka shqyrtuar. Pse ndodh kjo? Çështja tjetër që e ngriti, ishte ajo e telefonatave anonime. A mund të jenë ato pengesë për punën e Agjencisë?

Drejtori i Agjencisë - Shtoi se problemi me Këshillin e Agjencisë është se ai këmbëngul të ketë qasje në dosjet që janë duke u hetuar nga Agjencia, edhe pse për to raportojmë në Këshill çdo 6 muaj. Për legjislacionin, tha se në Qeveri, janë hartuar edhe tri projektligje. Sa i përket strategjisë më duhet të qartësoj se ajo i cakton detyrat e institucioneve të tjera të Kosovës, ndërsa detyrat e Agjencisë i cakton ligji. U pajtua se nuk ka pasur përkrahje të duhur politike. Theksoi se raportet e Agjencisë me prokuroritë dhe me gjykatat duhet të jenë shumë më të mira. Sa i përket kërkesës për shkarkim, këtë e mundëson ligji. Ju siguroj se emrat i di vetëm Prokuroria, sepse nuk kanë dalë nga Agjencia. Vuri në pah se lufta kundër korrupsionit nuk i takon vetëm Agjencisë, por të gjitha hallkave të sistemit. Hetimet nuk i fillojmë menjëherë posa të merret telefonata anonime, meqë ai është kontakti i parë me Agjencinë.

Kryetari – E falënderoi drejtorin e Agjencisë për Raportin dhe diskutimin e tij në Komision. Premtoi se do ta ketë mbështetjen e Komisionit dhe raporti do të procedohet në Kuvend.

E hartoi stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni